



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 2927 Prot.

Tiranë, më 29 / 09 /2023

**Lënda:** Kërkohej mocion me debat, si dhe shqyrtimi dhe miratimi në seancën plenare të Projektrezolutës “Për dënimin me termat më të ashpër të sulmit terrorist të organizuar nga Republika e Serbisë mbi Policinë e Kosovës më datën 24 shtator 2023”

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**Baza Ligjore:** Nenet 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit

E nderuar znj. Kryetare,

Në periudhën 23-24 shtator 2023, dy kamionë pa targa janë vendosur në një urë në hyrje të fshatit Banjskë, Kosovë, duke bllokuar rrugën. Bllokada u raportua në polici në orët e para të mëngjesit të datës 24 shtator. Rreth orës 02:30 në vendngjarje kanë mbërritur 3 njësi policore, të cilat janë sulmuar nga drejtime të ndryshme nga një grup i armatosur prej rreth 30 personash, me armë të ndryshme. Në këtë sulm mbeti i vrarë rreshteri i policisë së Kosovës Afrim Bunjaku. Sulmi ndaj Policisë së Kosovës u cilësua si sulm terrorist nga Kosova dhe Bashkimi Evropian dhe u dënua nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kjo ngjarje, është në vijim të veprimeve të mëparshme të Republikës së Serbisë, për mosnjohjen e realitetit që Republika e Kosovës është e pavarur dhe sovrane në të gjithë territorin e saj, dhe provon se në shkelje të ligjit ndërkombëtar Republika e Serbisë organizon dhe mbështet veprime që cenojnë sigurinë dhe rendin kushtetutes të Republikës së Kosovës.

Republika e Shqipërisë ka detyrimin kushtetutes sipas neni 8 që të mbrojë të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj. Në këtë kuptim, institucionet e shtetit shqiptar, përfshirë Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, duhet të heqin dorë nga deklaratat, sjellja dhe roli i tyre neutral mbi situatën në veri të Kosovës. Kryeministri i Shqipërisë dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të shtetit shqiptar duhet të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese, duke qenë plotësisht vetëm në mbështetje të institucioneve të Kosovës dhe popullit të Kosovës, në bashkërendim të plotë edhe me partnerët ndërkombëtar të Kosovës e Shqipërisë.

Kuvendi i Kosovës më datë 28.09.2023 ka miratuar një Rezolutë mbi sulmin terrorist të datës 24 Shtator, ku jo vetëm dënon sulmin, por kërkon edhe anagazhim të institucioneve për të kërkuar hetim ndërkombëtar. Në vlerësimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, duke mbështetur plotësisht punën e Policisë dhe institucioneve shtetërore të Kosovës, për ruajtjen e integritetit të

tyre territorial dhe funksionimin e shtetit ligjor në çdo pjesë të territorit të Kosovës, gjykojmë që është e nevojshme që edhe Kuvendi i Shqipërisë ti bashkohet qëndrimit të Kuvendit të Kosovës, duke miratuar një rezolutë të njëjtë dhe duke unifikuar qëndrimin mes dy shteteve tona.

Nisur nga sa më sipër, përfshirë disa qëndrime kontraditore dhe që bien ndesh me interesin e Kosovës nga ana e Kryeministrit të Shqipërisë, duke e konsideruar këtë një moment të rëndësishëm për zhvillimet në Kosovë, në mbështetje të nenit 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, paraqesim këtë mocion me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për qëndrimin e shtetit shqiptar në raport me zhvillimet në Kosovë. Në përfundim të tij, propozojmë miratimin e një rezolute, sipas tekstit bashkëlidhur kësaj kërkesë për zhvillimin e mocionit. Në mbështetje të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Shqipërisë të ProjektRezolutës “Për dënimin me termat më të ashpër të sulmit terrorist të organizuar nga Republika e Serbisë mbi Policinë e Kosovës më datën 24 shtator 2023”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, kërkojmë ndjekjen e procedurës parlamentare për zhvillimin e mocionit me debat në seancën më të afërt plenare dhe miratimin e Rezolutës.

#### **GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE**

**KRYETARI  
GAZMENT BARDHI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKT

REZOLUTË

Nr. \_\_\_\_/2023

**PËR DËNIMIN ME TERMAT MË TË ASHPËR TË SULMIT TERRORIST TË  
ORGANIZUAR NGA REPUBLIKA E SERBISË MBI POLICINË E KOSOVËS MË  
DATËN 24 SHTATOR 2023**

*Duke marrë për bazë gjendjen e sigurisë nëpër të cilën po kalon Kosova pas sulmit terrorist të organizuar nga Republika e Serbisë ndaj sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës;*

*Duke vlerësuar rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës si dhe përcaktimin dhe angazhimin shtetëror të Republikës së Shqipërisë për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit në rajon;*

*Të vendosur për të kontribuar që Republika e Kosovës të jetë vend i lirë, demokratik, paqedashës dhe atdhe i qytetarëve të saj, të cilëve ju garantohen të drejtat, liritë dhe barazia para ligjit;*

*Të përkushtuar për të mbështetur luftën dhe parandalimin me mjete kushtetuese dhe ligjore të çfarëdo veprimi dhe përpjekje për të cënuar, rrezikuar apo sulmuar rendin kushtetutes të Republikës së Kosovës;*

*Të ndërgjegjshëm që sipas nenit 8 të Kushtetutës “Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj”;*

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:**

1. DËNON me termat më të ashpër sulmin terrorist të organizuar nga Republika e Serbisë mbi Policinë e Kosovës më datën 24 shtator 2023, si dhe kërkon nga faktori ndërkombëtar që të ushtroj ndikimin e tij për ta ballafaquar Serbinë me rolin e saj në raport me organizimin dhe mbështetjen e çdo llojshme që i ka bërë grupit terrorist për sulmin në veri të Republikës së Kosovës.

2. VLERËSON punën, angazhimin dhe rezultatet e jashtëzakonshme të institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës, institucioneve kushtetutese të Republikës së Kosovës dhe të institucioneve partnere ndërkombëtare të sigurisë (EULEX dhe KFOR), në aksionin e përbashkët për të zbrapsur dhe asgjësuar sulmet terroriste të organizuara nga Serbia në veri të Kosovës.

3. OFRON mbështetjen e plotë dhe të rezervë për Kosovën dhe institucionet e saj, në ushtrimin e përgjegjësisë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

4. MBËSHTET të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të vazhdojnë punën e përbashkët për integrimin e plotë dhe bashkëjetesën mes të gjitha komuniteteve pa dallim që jetojnë në Republikën e Kosovës.

5. INKURAJON dhe MBËSHTET pluralizimin politik në radhët e komunitetit serb në Kosovë, zhvillimi i të cilit mundëson progresin demokratik dhe rrit transparencën e llogaridhënien para këtij komuniteti dhe jetëson promovimin e interesave reale të tij në Republikën e Kosovës.

6. KËRKON nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë që të bashkëpunojë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe aleatët ndërkombëtarë, veçanërisht me SHBA-të, për të fuqizuar Shtetin e së Drejtës dhe vlerat e përbashkëta euro-atlantike në Republikën e Kosovës.

7. KONSTATON nevojën për hetim ndërkombëtar ndaj Republikës së Serbisë lidhur me organizimin e aktiviteteve terroriste dhe vazhdimin e ekzistencës së kampeve stërvitore të grupeve terroriste në territorin e Serbisë, si dhe kërkon nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë që të ndërmarrë çdo iniciativë apo nismë të nevojshme në këtë drejtim, duke përbushur detyrimin kushtetutes të mbrojtjes së të drejtave kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**